

VENDIM
Nr.1277, datë 23.12.2009

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 500, DATË 14.8.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE DHE TRANSFERIMIN E PRONAVE NË NJËSITË E QEVERISJES
VENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 21 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 31 të vendimit nr.500, datë 14.8.2001 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 32, 33, 34, 35, 36, 37 e 38, me këtë përmbajtje:

“32. Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, kryen:

a) identifikimin e pasurive shtetërore të paluajtshme në administrim të sindikatave;
b) inventarizimin e pasurive shtetërore të paluajtshme, në administrim të sindikatave;
c) identifikimin, sapo ka marrë dijeni, të marrëdhënieve të krijuara me të tretët për pasuritë në administrim të sindikatave, verifikimin e tyre apo përdor mënyra të tjera të njohura nga ligji;

ç) identifikimin e objekteve të kulturës të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilat kanë kaluar apo duhet të kalonin në pronësi të qeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi.

33. Agjencia, në zbatim të pikës 32, bashkërendon punën me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas procedurës së përcaktuar më sipër në këtë vendim. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dërgojnë në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 6 të vendimit, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

34. Gjatë identifikimit të pasurive të paluajtshme të sindikatave, në rastet kur këto pasuri rezultojnë të jenë të paregjistruara më parë në regjistrat e ZRRPP-ve, AITPP-ja kërkon regjistrimin e këtyre pasurive në zyrën vendore përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm, me të cilin provohet e drejta e pronësisë.

35. Inventarizimi i pasurive të luajtshme, të cilat janë sende, aksesore të pasurive të paluajtshme, në administrim të sindikatave, bëhet nga AITPP-ja dhe dokumentohet në procesverbalin tip të miratuar, sipas formularit standard, me udhëzimet përkatëse për plotësimin e tyre.

36. Inventarizimi kryhet nga një grup pune, i ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm, ku të marrin pjesë të paktën 2 punonjës të AITPP-së, të caktuar nga titullari, si dhe ftohen pjesëmarrës nga institucione të tjera. Ky grup pune harton inventarin në bazë të pasurive të luajtshme të identifikuara.

37. AITPP-ja, pas përfundimit të afatit tremujor, raporton pranë Këshillit të Ministrave për veprimtarinë e vet për inventarizimin e pronave, në administrim të sindikatave. Raportimi duhet të përmbajë të dhënat për:

a) numrin dhe llojin e pasurive të paluajtshme të inventarizuara;
b) numrin e pasurive të luajtshme të inventarizuara;
c) llojin e marrëdhënieve të krijuara me të tretët, për pasuritë në administrim të sindikatave, dhe ndryshimin e kësaj marrëdhënieje, nëse ka, ku përshihen:

- i) kontratat e qirave me të tretët;
- ii) kontratat e përdorimit me të tretët.
- iii) vënia e hipotekave mbi pasuritë, në favor të të tretëve;
- iv) çdo lloj veprimi juridik, i kryer për këto pasuri, që regjistrohet në regjistrat publikë;

ç) listën e objekteve të kulturës së ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilat kanë kaluar apo duhet të kalonin në pronësi të qeverisjes vendore, të identifikuara;

d) listën e të gjitha objekteve të inventarizuara;

dh) çdo informacion tjetër të nevojshëm, që lidhet me procesin.

38. AITPP-ja, pas përfundimit të procesit të identifikimit e të inventarizimit të pronave, në administrim të sindikatave, vijon, rast pas rasti, procedurat e parashikuara në këtë vendim, për regjistrimin e pronave të paluajtshme, në përputhje me ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha